



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

# Zbatimi i Rekomandimeve, të lëna në auditime të mëparshme (pjesa I)

Qershor 2026



+355 4 2247294



[www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)



# PËRMBAJTJA

	HYRJE	5
	PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE	8
	KUFIZIME	9
	REZULTATET SIPAS AUDITIMEVE	10
	PËRMBAJTJA E TABELAVE	41





*"SAI-et janë kujdestarët e besimit publik. Ata e fitojnë atë besim përmes auditimeve rigoroze, por arrijnë ta mbajnë atë vetëm përmes ndjekjes efektive "*

**XXIV INCOSAI**




### POPULLATA E AUDITIMIT

#### Gjithsej 57 auditime

- **33 Auditime përputhshmërie**
- **2 Auditime financiare**
- **8 Auditime të kombinuara**
- **6 Auditime performance**
- **2 Auditime tematik**
- **6 Auditime IT**

#### Gjithsej 1808 rekomandime

- **1072 Masa organizative**
- **17 Përmirësime ligjore**
- **248 Efekte financiare (në numër)**
- **462 Masa disiplinore**
- **9 Masa administrative**

 Gjatë procesit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, puna e KLSH mbështetet në:

“Kompetencat e Institucioneve Supreme të Auditimit” parashikuar në INTOSAI-P 1 “Deklarata e Limës”, ku parashikohet se subjekti i audituar duhet të komentojë mbi rezultatet e auditimit brenda një periudhe kohe të vendosur me ligj ose nga SAI, si dhe të paraqesë masat e marra për zbatimin e rekomandimeve;

Deklaratën e Meksikos, konkretisht në INTOSAI-P 10 “Mbi pavarësinë e SAI-eve”; INTOSAI-P 11 “Ekzistenca e mekanizmave të ndjekjes së rekomandimeve të SAI-t”; INTOSAI-P 12 “Vlerat dhe përfitimet e SAI-eve - të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”;

Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në nenet 15 dhe 30 të të cilit parashikohet periudha e kthimit të përgjigjes si dhe e drejta e KLSH për t’iu drejtuar organeve më të larta të kompetencës në rast të moszbatimit të rekomandimeve të lëna; si dhe në Manualin “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 67, datë 13.06.2020

### OBJEKTIVAT

Performanca institucionale nuk mund të arrihet pa konsolidimin e një sistemi efektiv të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe kjo është rruga e vetme e përbushjes së qëllimeve strategjike të misionit dhe vizionit institucional, si dhe pritshmërive të Kuvendit, publikut dhe gjithë palëve të interesit. Sa më sipër gjithashtu në linjë me objektivin strategjik nr. 2 të KLSH-së, nëpërmjet të cilit KLSH synon të rrisë impaktin e punës audituese dhe të kontribuojë në mirëqeverisje, përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe transparencë të fondeve publike, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve konkrete

### ROLET

Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP), përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësive të subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-eve), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe me efektivitet është e subjekteve të audituara; por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, pra verifikimi nëse veprimet e ndërmarra i shërbejnë rezultatve të pritshme.

### PËRFITIMET

Procesi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe iniciimi e zbatimi i masave korigjuese nga subjektet e audituara, jep një informacion të detajuar mbi vlerën e shtuar që sjell puna e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe njëherazi jep garanci për profesionalizmin, pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit.

Konsolidimi i një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara, i lejon jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë etj, të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative. Për këtë qëllim, KLSH popullon në mënyrë periodike, me të dhëna, Platformën Ndërinstitucionale të Kuvendit.


Skemat dhe qasja e përdorur për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, synojnë të gjenerojnë indikatorë të konsoliduar institucional, sa i takon pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit ndaj ekzekutivit, me efekt rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.

## ZBATIMI I REKOMANDIMEVE (PJESA I)



Nga verifikimi mbi respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjies 20 ditore, rezultoi se:


në zbatim të nenit 15, pika j, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **57 subjekte** kanë kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, mbi statusin e rekomandimeve të lëna; dhe 18 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje, në kundërshtim me nenin 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".



Burimi: Shkresat dërguar nga subjektet e audituara


Nga verifikimi mbi respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjies 6 mujore, rezultoi se:

në zbatim të nenit 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", 26 subjekte kanë kthyer përgjigje brenda 6 muajve, mbi statusin e rekomandimeve të lëna; 47 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje, në kundërshtim me nenin 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", dhe 2 subjekte nuk kanë përmbushur afatin 6 mujor.



Burimi: Shkresat dërguar nga subjektet e audituara

Referuar përgjigjeve sa më sipër, dhe më pas edhe verifikimit të tyre në terren, rezultoi se nga **1808** rekomandime të lëna gjithsej, **1787 rekomandime janë pranuar, ose rreth 99%** e total rekomandimeve; dhe nuk janë pranuar **21** rekomandime, ose rreth **1%** e tyre.



Burimi: Shkresat e subjekteve të audituara

Në përfundim, 1250 masa ose **rreth 70%** e tyre rezultuan të zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi. Konkretisht, nga total 1787 masa të pranuar, 667 masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 37% e total masave të pranuar), 205 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 11% e total masave të pranuar), 378 në proces zbatimi (ose rreth 21% e total masave të pranuar); ndërsa 537 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 30% e total masave të pranuar).



## 2. PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE

Nga verifikimet e kryera, për **57 auditime**, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, rezultoi se janë dhënë gjithsej 1808 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 1787 masa, ose 99% (që përfshijnë 17 përmirësime ligjore, 1065 masa organizative, 69 masa shpërblim dëmi, 172 masa për shpenzime pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet, 9 masa administrative dhe 455 masa disiplinore) dhe nuk janë pranuar 21 masa, ose rreth 1%.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga 1787 masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 667\* masa ose 37%, pjesërisht 205 masa, ose 11%; janë në proces zbatimi 378 ose 21%; ndërsa 537 masa, ose rreth 30% nuk janë zbatuar, të cilat janë grupuar sipas llojit dhe paraqiten si vijon:

**A.** Rekomanduar gjithsej 17 "Masa për përmirësime ligjore", nga të cilat janë pranuar 17 masa ose 100%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 4 masa ose 24%, në proces zbatimi 6 masa ose 35% dhe pa zbatuar 7 masa, ose 41%.

**B.** Rekomanduar gjithsej 1072 "Masa organizative", nga të cilat janë pranuar 1065 masa ose në masën 99% dhe nuk janë pranuar 7 masa, ose 1%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 372 masa ose 35%, zbatuar pjesërisht 101 masa ose 9%, janë në proces zbatimi 327 masa ose 31%, nuk janë zbatuar 265 ose 25% e tyre.

**C.** Rekomanduar gjithsej 74 "Masa për shpërblim dëmi (në numër)", nga të cilat janë pranuar 69 masa ose 93% dhe nuk janë pranuar 5 masa ose 7%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 37 masa ose 54%, pjesërisht 9 masa ose 13%, janë në proces zbatimi 8 masa ose 12% dhe nuk janë zbatuar 15 masa ose 22%.

**D.** Rekomanduar gjithsej 111 "Masa për eliminimin e efekteve negative (në numër)", nga të cilat janë pranuar 110 masa ose 99% dhe 1 masë nuk është pranuar ose 1%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 21 masa ose 19%, pjesërisht 14 masa ose 13%, janë në proces zbatimi 33 masa ose 30% dhe nuk janë zbatuar 42 masa ose 38%.

**E.** Rekomanduar gjithsej 63 "Masa në sistemin tatimor dhe doganor", nga të cilat janë pranuar 62 masa ose 98% dhe 1 masë nuk është pranuar ose 2%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 29 masa ose 47%, pjesërisht 18 masa ose 29%, janë në proces zbatimi 4 masa ose 6% dhe nuk janë zbatuar 11 masa ose 18%.

**F.** Rekomanduar gjithsej 462 "Masa disiplinore", nga të cilat janë pranuar 455 masa ose 98% dhe nuk janë pranuar 7 masa ose 2%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 200\* masa ose 44%, pjesërisht 61 masa ose 13%, nuk janë zbatuar 194 masa ose 43%.

**G.** Rekomanduar gjithsej 9 "Masa administrative", të cilat janë pranuar në masën 100%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 masa ose 44%, pjesërisht 2 masa ose 22% dhe nuk janë zbatuar 3 masa ose 33%.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë.

\*Këtu janë përfshirë dhe 53 rekomandime për "masë disiplinore"; që nuk janë më relevante



### 3. KUFIZIME

Pavarësisht verifikimit të zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të konstatuara nga KLSH dhe të paraqitura në këtë raport, procesi në vetvete mbart disa kufizime, të cilat mund të ndikojnë në treguesit e raportuar dhe që duhen mbajtur në konsideratë në vijim.



Ndryshe nga auditimet tradicionale financiare ose të pajtueshmërisë, auditimet e performancës fokusohen në vlerësimin e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të operacioneve ose programeve të një ose më shumë institucioneve publike, pjesë e të njëjtit sistem/proces. Si rezultat, rekomandimet që rrjedhin nga auditimet e performancës shpesh kërkojnë ndryshime të shumëanshme që përfshijnë sisteme, procese ose politika komplekse. Këto auditime shkojnë përtej identifikimit të thjeshtë të çështjeve; ato analizojnë shkaqet kryesore, propozojnë zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe shpesh kërkojnë ristrukturim ose riinxhinierim të rëndësishëm për t'u zbatuar në mënyrë efektive.

Rrjedhimisht, zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e performancës kërkon një proces më të ndërlikuar që kërkon kohë dhe që përfshin bashkëpunimin e palëve të interesuara, shpërndarjen e burimeve, rregullimet e politikave dhe ndonjëherë ndryshime legjislative ose organizative.

Kjo natyrë e ndërlikuar e adresimit të përmirësimeve sistemike kontribuon në një afat kohor më të zgjatur të zbatimit të rekomandimeve në auditimet e performancës, në krahasim me llojet e tjera të auditimit.



Gjithashtu mund të ketë edhe rekomandime, të cilat me kalimin e kohës, mund të rezultojnë jo relevante për shkak të ndryshimeve të diktuarat së jashtmi, dhe për pasojë nuk mund të zbatohen më.



### 4. REZULTATET SIPAS AUDITIMEVE

#### 1. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 185/14 prot., datë 01.08.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 20 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 10 në proces zbatimi, 1 zbatuar pjesërisht dhe 9 zbatuar plotësisht.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

#### 2. Banka e Shqipërisë

Nga auditimi i ushtruar në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 655/12, datë 31.12.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 rekomandime masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 2 rekomandime dhe pa pranuar janë 4 rekomandime, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 në proces zbatimi dhe 1 zbatuar pjesërisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.



### 3. Dega Doganore Tiranë

Nga auditimi i ushtruar në Degën Doganore Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 1113/23 prot., datë 31.12.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime për përmirësim ligjor, masa të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar pa zbatuar.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 16 rekomandime masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 15 rekomandime dhe pa pranuar është 1 rekomandim, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 6 pa zbatuar, 6 në proces zbatimi, 1 zbatuar pjesërisht dhe 2 zbatuar plotësisht.

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 13 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 6 pa zbatuar, 2 në proces zbatimi, 3 zbatuar pjesërisht dhe 2 zbatuar plotësisht.

d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 51 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 46 zbatuar pjesërisht dhe 5 zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

### 4. Dega e Doganës Kakavijë

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Kakavijë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 858/20 prot., datë 05.03.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 16 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 pa zbatuar, 1 në proces zbatimi, 2 zbatuar pjesërisht dhe 12 zbatuar plotësisht.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilat janë pranuar plotësisht 3 rekomandime dhe pa pranuar është 1 rekomandim, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 zbatuar pjesërisht dhe 1 zbatuar plotësisht.

c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore, e cila është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.



### 5. Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 1112/33 Prot., datë 15.07.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkzionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkzionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 21 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 8 në proces zbatimi, 2 zbatuar pjesërisht dhe 11 zbatuar plotësisht.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 23 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 zbatuar pjesërisht dhe 21 zbatuar plotësisht.

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 21 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

### 6. Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 1111/40 prot., datë 03.10.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkzionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkzionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 pa zbatuar, 2 në proces zbatimi, 1 zbatuar pjesërisht dhe 12 zbatuar plotësisht.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 23 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 5 pa zbatuar, 2 në proces zbatimi, 11 zbatuar pjesërisht dhe 5 zbatuar plotësisht.

c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore, e cila është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.



### 7. Ministria e Brendshme

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Brendshme, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 169/10 prot. datë 09.09.2024, rezultoi se:

- subjekti nuk ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 35 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 pa zbatuar, 15 në proces zbatimi, 1 zbatuar pjesërisht dhe 17 zbatuar plotësisht.
  - Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime masa shpërblim dëmi, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar pa zbatuar.
  - Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 në proces zbatimi.
- Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre, ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

### 8. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nga auditimi i ushtruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 640/20 prot., datë 10.03.2025, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 20 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 pa zbatuar, 7 në proces zbatimi, 2 zbatuar pjesërisht dhe 10 zbatuar plotësisht.
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 pa zbatuar dhe 1 në proces zbatimi.
- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore, e cila është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre, ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.



### 9. Instituti i Statistikave

Nga auditimi i ushtruar në Institutin e Statistikave, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 505/8 prot., datë 03.10.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 36 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 3 pa zbatuar, 17 në proces zbatimi, 4 zbatuar pjesërisht dhe 12 zbatuar plotësisht.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 pa zbatuar dhe 1 në proces zbatimi.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 12 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 10 pa zbatuar dhe 2 zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

### 10. Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nga auditimi i ushtruar në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr.247/9 prot., datë 06.08.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 30 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 pa zbatuar, 16 në proces zbatimi, 1 zbatuar pjesërisht dhe 12 zbatuar plotësisht.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime masa shpërblim dëmi, të cilat nuk janë pranuar.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 në proces zbatimi dhe 2 zbatuar plotësisht.
- d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.



### 11. Akademia e Sigurisë

Nga auditimi i ushtruar në Akademinë e Sigurisë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 646/8 datë 20.12.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime për përmirësime ligjore, masa të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar në proces zbatimi.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 36 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 pa zbatuar, 14 në proces zbatimi, 1 zbatuar pjesërisht dhe 19 zbatuar plotësisht.
- c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 rekomandim masë shpërblim dëmi, i cili është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar zbatuar plotësisht.
- d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar zbatuar plotësisht.
- e) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë administrative, e cila është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar zbatuar plotësisht.
- f) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 8 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 pa zbatuar dhe 7 zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

### 12. Universiteti i Tiranës

Nga auditimi i ushtruar në Universitetin e Tiranës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi kryerjen e verifikimit të çështjeve të trajtuara në ankesën nr. 638 prot., datë 07.05.2024" trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 368/10 prot., datë 30.12.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 pa zbatuar dhe 1 zbatuar plotësisht.



### 13. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Tiranë

Nga auditimi i ushtruar në Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në periudhën 01.07.2023 - 31.12.2023", trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 792/23 prot., datë 21.11.2024, rezultoi se:

- subjekti nuk ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe nuk ka dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 33 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 22 pa zbatuar dhe 11 zbatuar pjesërisht.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 rekomandime masa shpërblim dëmi, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar zbatuar plotësisht.

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 3 pa zbatuar dhe 1 zbatuar plotësisht.

d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë administrative, e cila është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar zbatuar pjesërisht.

e) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar pa zbatuar.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre.

### 14. Agjencia për Eficiencën e Energjisë

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë për Eficiencën e Energjisë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 1043/16 prot., datë 03.10.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe nuk ka dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 19 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 pa zbatuar, 4 në proces zbatimi dhe 13 zbatuar plotësisht.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 rekomandime masa shpërblim dëmi të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 në proces zbatimi dhe 3 zbatuar plotësisht.

c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 rekomandim për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, i cili është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar në proces zbatimi.

d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 12 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar: 10 pa zbatuar dhe 2 zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përsheptimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.



### 15. Albcontrol

Nga auditimi i ushtruar në Albcontrol, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 347/9 Prot., datë 12.12.2024, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
